



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2018:061823

Datë: 06.05.2020

Numri i dokumentit: 00916580

P.nr.1004/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DIVIZIONI PENAL, si gjykatë e shkallës së parë penale e përbërë nga gjyqtari i vetëm gjykues Ilir Bytyqi, me asistentin Muedin Rexhepi, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarit B.B nga fshati ..., Komuna Ferizaj, për shkak të dy veprave penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzave të Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/II.nr.1510-3/18 të datës 30.07.2018 dhe PP/II.nr.2102-4/17 të datës.04.12.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe publik, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit të shtetit Luljeta Bilalli si dhe të akuzuarit G.B, me datën 24.02.2020 mori dhe publikisht komunikoi, ndërsa me datë 09.03.2020 përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari: G.B nga fshati ..., Komuna Ferizaj, i lindur me dt.... nga i ati Rr... dhe nëna L... e vajzërisë H..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, i pa punë, me gjendje të dobët ekonomike, posedon letërnjoftim me numër personal

ËSHTË FAJTOR

Sepse:

1. Me datë 11.07.2018, rreth orës 16:30, në vendin e quajtur “N...”, në rajonin ekonomiko-pyjor Neredime-Jezercë, me qëllim vjedhje, me sharrë motorike ka prerë 4 dru ahu,

boniteti III, me diametër 28-50 cm, në vëllim prej 4.13m³, të cilat i bartë me traktor me të cilin veprim ka dëmtuar DBP-në në Ferizaj në vlerën prej 506.90 €

me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

2. Me datë 23.09.2017, rreth orës 14:30, në pyllin shoqëror të cilin e menaxhon Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, në rajonin ekonomik-pyjor Neredime-Jezercë, në vendin quajtur “P...”, me qëllim vjedhje ka prerë 3 dru të llojit ahu, me diametër 10-60 cm, lartësi boniteti III, gjithsej në kubaturë prej 4.67 m³ vlera e dëmit të shkaktuar është 630,45 € të cilat drunjë i ka bartur me traktor IMT 39.

me këtë ka kryer veprën penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve të sipërcekura dhe neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42, 43, 46 dhe 73 të KPRK-së si dhe neneve 365, 370, 453, 463, të KPPK-së, të akuzuarin G.B i

CAKTON DËNIM

- Për pikën një të dispozitivit, për veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së dënim me gjobë në shumën prej 200 € (dyqind Euro).
- Për pikën një të dispozitivit, për veprën penale vjedhje e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së dënim me gjobë në shumën prej 200 € (dyqind Euro).

Gjykata konform dispozitës ligjore të nenit 80 të KPRK-se, të akuzuarin G.B e

GJYKON ME DENIM UNIK

- Dënim me gjobë në shumën prej 400 Euro (katërqind euro), të cilën gjobë do ta paguaj në afat prej 15 ditëve pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

- Në rast se i akuzuari nuk e paguan dënimin me gjobë në asnjë mënyrë, sipas nenit 46 par.3 të KPRK-së, i njëjti dënim do t'i shndërrohet në dënim me burgim ashtu që për çdo 20 Euro, do t'i llogaritet 1 (një) ditë burgim.
- Obligohet i akuzuari që të dëmtuarës Drejtorisë për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj, t'ia paguaj dëmin e shkaktuar në vlerë të përgjithshme prej 1137.05 Euro (njëmijë e njëqind e tridhjetë e shtatë euro), në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.
- Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 30 Euro (tridhjetë), në afatin prej 15 ditësh pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.
- Obligohet i akuzuari që konform nenit 39 par. 3 pika 3.1 të ligjit Nr. 05/L-036, për kompensimin e viktimave të krimit, të paguajë shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, brenda afatit prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin të përmbarimit me dhunë.

A r s y e t i m

Historiku u procedurës

Gjykata Themelore në Ferizaj, pasi studioi materialet e çështjes penale të paraqitur për gjykim, çmoi se çështja është në juridiksionin e saj dhe gjykimi i kësaj çështje penale duhet te realizohet përpara kësaj gjykate. Po ashtu është në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj gjykate, pasi veprat penale për të cilat është proceduar i akuzuari gjykohet nga gjyqtari i vetëm gjykues dhe vendi ku është kryer ose tentohet të kryhet vepra penale është në juridiksionin e kësaj gjykate.

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzat PP/II.nr.1510-3/18 të datës 30.07.2018 dhe PP/II.nr.2102-4/17 të datës 04.12.2017 ka ngarkuar të akuzuarin G.B nga fshati ..., komuna Ferizaj, për veprat penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së.

Bashkimi i procedurës

Gjyqtari i vetëm gjykues në shqyrtimin fillestar të mbajtur me datën 24.02.2020 pasi ka konstatuar se ndaj të akuzuarit G.B, Prokuroria Themelore në Ferizaj ka paraqitur në këtë gjykatë dy aktakuza dhe atë aktakuzën PP/II.nr.1510-3/18 të datës 30.07.2018 dhe PP/II.nr.2102-4/17 të datës 04.12.2017, duke vepruar sipas detyrës zyrtare por edhe me pëlqimin e prokurores së shtetit dhe të akuzuarit, ka urdhëruar bashkimin e procedurës penale sipas numrave të lëndëve të evidentuara në këtë gjykatë dhe atë P.nr.1004/18 dhe P.nr.3089/17 dhe në procedurën e mëtutjeshme lënda është udhëhequr sipas numrit bartës P.nr.1004/18, këtë pasi në të dy këto aktakuza bëhet fjalë për të njëjtin person si kryes, natyrën e njëjtë të veprave penale, dashja dhe objekti i njëjtë i kryesit të veprave, por edhe për shkak të institutit të ekonomizimit të procedurës penale, si dhe pas marrjes së mendimit të palëve lidhur me bashkim të procedurës penale, gjykata në kuptim të nenit 35 par.1 dhe 8 të KPPK-së, vendosi që të zhvillohet një procedurë unike në lëndët kundër të akuzuarit G.B.

Pas bashkimit të procedurës penale në shqyrtimin fillestar në mbështetje të nenit 245 par.2 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari në mënyrë të rregullt ka pranuar kopjet e aktakuzave nga ana e Prokurorisë Themelore në Ferizaj si dhe ka konstatuar se janë plotësuar detyrimet lidhur me zbulimin e provave të parapara ë nenin 245 par.4 të KPPK-së.

Deklarimet e palëve dhe provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor.

Pasi gjykata ka udhëzuar të akuzuarin në kuptim të nenit 246 par.1 të KPPK-së dhe pasi që i akuzuari ka deklaruar se i ka kuptuar në tërësi udhëzimet e dhëna nga gjykata, në pajtim me nenin 346 par.3 të KPPK-së, shqyrtimi fillestar ka vazhduar me leximin e aktakuzave nga ana e prokurorit të shtetit dhe pasi që gjykata është bindur se i akuzuari i ka kuptuar në tërësi aktakuzat e lexuara, konform nenit 246 par.4 të KPPK-së, i ka ofruar mundësinë që të deklarohet lidhur me fajësinë apo pafajësinë e tij për veprat penale për të cilën është akuzuar.

Përkitazi me këtë i akuzuari G.B me rastin e deklarimit lidhur me fajësinë apo pafajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, në shqyrtimin fillestar ka theksuar se e ndien veten fajtorë dhe e pranon fajësinë për të dy veprat penale për të cilat akuzohet suipas këtyre dy aktakuzave, këtë sipas të gjitha pikave të këtyre aktakuzave, pranimin e ka bërë në mënyrë vullnetare duke qenë i vetëdijshëm për pasojat që mund të vijnë si rezultat i pranimin të

fajësisë dhe ka shtuar se i vjen keq për veprat penale të cilat i ka kryer, por këto i ka bërë për shkak të kushteve të vështira ekonomike, ka njoftuar se që dy vite gjendet jashtë shtetit dhe nuk ka përsëritur gjëra të tilla dhe ka kërkuar nga gjykata që të merr parasysh të gjitha rrethanat dhe t'i shqiptojë një dënim sa më të bute.

Pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues duke vepruar në pajtim me nenin 248 par.2 të KPPK-së ka kërkuar edhe mendimin e prokurorit të shtetit.

Prokurorja e shtetit Luljeta Bilalli duke shprehur mendimin e sajë lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit meqë ky pranim është i bazuar në gjendjen faktike të përshkruar në dispozitivin e kësaj aktakuze, pranimin e fajësisë i akuzuari e ka bërë vullnetarisht dhe se një pranim i tillë është në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 248 të KPPK-së si dhe provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ndërsa i ka propozuar gjykatës që të akuzuarit t'i shqiptojë dënim në pajtim me ligjin.

Provat e paraqitura në shqyrtimin fillestar dhe të gjeturat e gjykatës.

Meqë i akuzuari ka pranuar fajësinë në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par.1 të KPPK-së pasi i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmbajnë aktakuzat, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit, dhe në provat materiale të cilat gjenden në shkresën e lëndëve siç janë: fletëparaqitja e rojës së pyllit nr.ditari 50/2018 datë 16.07.2018, procesverbali mbi vlerësimin e dëmit NP.nr.276/18 datë 16.07.2018, fletëparaqitja e rojës së pyllit nr.ditari 70/2017 datë 03.10.2017, procesverbali mbi vlerësimin e dëmit NP.nr.665/17 datë 03.10.2017 si dhe shkresat tjera të lëndës. Aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Meqenëse i akuzuari ka pranuar fajësinë e cila është në përputhje me kriteret e parashikuara më lartë, gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 248 par.4 të KPPK-së ka vlerësuar se nuk është i nevojshëm vërtetimi i ndonjë fakti relevant për shqyrtimin e dënimit

dhe për këtë arsye ka vazhduar me shqiptimin e dënimit (*nëse i pandehuri në shqyrtimin fillestar pranon fajësinë dhe kryetari i trupit gjykues vlerëson se pranimi i fajit është bërë në pajtim me ligjin mundë të vazhdoj procedurën me shqiptimin e dënimit pa plotësuar trupin gjykues dhe pa mbajtur fare shqyrtimin gjyqësor, lidhur me këtë shih mendimin juridik të Gjykatës Supreme të evidentuar si GJA.nr.207/13 të datës 19.03.2013*).

Vlerësuar nga aspekti juridik gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprave penale vjedhja e pyllit nga neni 358 par.1 të KPRK-së, ashtu siç janë theksuar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, të përshkruara në datat, vendet, kohët dhe mënyrën apo rrethanat e kryerjes së këtyre dy veprave penale.

Matja dhe shqiptimi i dënimit

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KPRK-së, gjeti si rrethanë lehtësuese se në shqyrtimin fillestar i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat është akuzuar, duke shprehur pendimin e sinqertë dhe real për veprat penale të kryera, sjelljen e tij korrekte gjatë gjykimit, faktin se i akuzuari ka kërkuar falje publike dhe ka premtuar se veprime të tilla apo të ngjashme më nuk do të përsëris, ndërsa sa u përket rrethanave rënduese gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese veçse e vlerësoi peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, prandaj duke marrë parasysh tërësinë e këtyre rrethanave, të akuzuarit i shqiptoi dënim ashtu siç është theksuar edhe në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindjen se në rastin konkret do të arrihet qëllimi i dënimit në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjenerale, ku një dënim i tillë është adekuat dhe në proporcion të drejtë në raport me peshën e veprës penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale dhe personalitetin e të akuzuarit.

Kërkesa pasurore-juridike dhe shpenzimet e procedurës penale

Gjykata duke vendosur në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPK-së. ka obliguar të akuzuarin që të dëmtuarës Drejtoria për Bujqësi dhe Pylltari në Ferizaj t'ia kompensoj dëmin e

shkaktuar në shumën prej 1.137.05 € (njëmijë e njëqind e tridhjetë e shtatë euro), këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Vendimi mbi shpenzimet paushalle është marr në kuptim të dispozitës së nenit 453 par. 1 lidhur me nenin 450 par.2 nënpar.2.6 të KPPK-së.

Vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 39 par 3 pika 3.1, Nr. 05/L-036 të ligjit për kompensimin e Viktimave të Krimit.

Në bazë të së theksuarës më lartë u vendos si në dispozitivit të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,
DEPARTAMENTI PERGJITHSHEM**

P.nr.1004/18, datë 09.03.2020

Asistenti

Muedin Rexhepi

Gjyqtari i vetëm gjykues

Ilir Bytyqi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të aktgjykimit nëpërmjet kësaj Gjykate, kurse i dëmtuari mund të paraqet ankesë vetëm sa i përket vendimit për sanksionin penal.